



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __.06.2022

MBLEDHJA Nr. 24,
Datë 06.06.2022, ora 13:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Hënë, datë 06.06.2022, ora 13:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 24 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 31.05.2022
2. Mbi kërkesën e ISHTI-t për disa shtesa dhe ndryshime në “Rregulloren për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes”, miratuar me vendimin Nr.166, datë 10.10.2016, të bordit të ERE, e ndryshuar me Vendimin Nr.177, datë 08.11.2016, të Bordit të ERE
3. Mbi licencimin e shoqërisë “Salillari Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike
4. Mbi kërkesën e shoqërisë Liria Energji për modifikimin e licencës nr. 339, seria PV16K, dhënë nga bordi i ERE-s me vendimin nr. 51, datë 29.04.2016, për prodhimin e energjisë elektrike nga Hec “Shpella Poshtë 2” me kapacitet të instaluar 2300 kW
5. Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Hec-i Kabash Poroçan” sh.p.k.
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “Teodori” sh.p.k. për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 68, datë 11.04.2022, “Mbi kërkesën e koncesionarit “Teodori” sh.p.k., për transferimin e plotë të licencës së shoqërisë koncensionare “Teodori 2003” sh.p.k., nr. 87, seria PV09K dhënë me vendimin e bordit nr. 83, datë 04.11.2009, për një afat 30 vjeçar, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Zalli i Bulqizës” dhe Hec “Ternovë”, tek shoqëria “Teodori” sh.p.k.”
7. Mbi kërkesën e shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k. për rinovimin e licencës nr. 376, seria F17 në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 114, datë 27.07.2012, i ndryshuar

8. Mbi kërkesën e shoqërisë “Korça Photovoltaic Park” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2000 kW
9. Mbi kërkesën e shoqërisë “NTSP” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2000 kW
10. Mbi kërkesën e shoqërisë “Sun Beat System” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2000 kW
11. Mbi kërkesën e shoqërisë “Tren Sun System” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2000 kW
12. Mbi kërkesën e shoqërisë “Vokopola Energji” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Vokopola 1”, me kapacitet të instaluar 274 kW, “Vokopola 2”, me kapacitet të instaluar 3104 kW, dhe “Vokopola 3”, me kapacitet të instaluar 2297 kW, me kapacitet total të instaluar 5675 kW
13. Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore ndaj ERE-s për pagesat e rregullimit të vitit 2021
14. Çështje të tjera

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI